



## **Kosova do të implementojë Sistemin e Avancuar të Shpërndarjes së të Dhënave të Përgjithshme të FMN-së**

Një mision nga departamenti i statistikës i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) vizitoi Prishtinën nga 6-13 prill 2017, për të ndihmuar autoritetet kosovare në implementimin e Sistemit të Avancuar të Shpërndarjes së të Dhënave të Përgjithshme të FMN-së (anglisht: Enhanced General Data Dissemination System e-GDDS), i cili është miratuar nga Bordi Ekzekutiv i FMN-së në maj të 2015. Misioni ka mbështetur avancimin e Faqes Përmbledhëse të të Dhënave Kombëtare (anglisht: National Summary Data Page - NSDP). Verzioni i ri do të postohet në faqen e internetit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) dhe do të mundësojë Këmbimin e të Dhënave dhe Metadatave Statistikore (anglisht: Statistical Data and Metadata Exchange - SDMX). Faqja NSDP përmban vegëzat e statistikave të publikuara nga prodhuesit zyrtarë të statistikave, përkatësisht BQK, Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Ministria e Financave. Faqja ka për qëllim të shërbejë si mjet ku do të publikohen të gjitha statistikat themelore makroekonomike.

Publikimi i të dhënave themelore makroekonomike nëpërmes verzionit të ri të faqes NSDP do t'u mundësojë përpiluesve të politikave dhe akterëve kombëtaër dhe ndërkombëtarë, përfshirë investitorët dhe agjencitë për kategorizim, një qasje të lehtë në informata të cilat Bordi Ekzekutiv i FMN-së i ka identifikuar si kritikë për monitorimin e kushteve dhe politikave ekonomike. Duke i bërë këto informata lehtësisht të qasshme si në aspektin njerëzor ashtu edhe në formatet e lexueshme nga makinat, si dhe sipas një Kalendarit Paraprak të Publikimeve do t'ua mundësojë të gjithë përdoruesve një qasje të menjëhershme në të dhënat e përditësuara dhe njëkohësisht do të sjellë një transparencë më të madhe.

Autoritetet janë të inkurajuar nga progresi që Kosova ka bërë për të arritur këtë sukses të rëndësishëm statistikor. Verzioni i ri i NSDP-së do t'u mundësojë përdoruesve qasjen e plotë në informatat për kategoritë e GDDS-së deri më 11 maj 2017.

*Sistemi i GDDS është themeluar nga Bordi Ekzekutiv i FMN-së në maj të 2015, me qëllim të përkrahjes së përmirësimit të transparencës së të dhënave, inkurajimit në zhvillimin e statistikave, dhe për të ndihmuar në krijimin e sinergjisë ndërmjet shpërndarjes së të dhënave dhe monitorimit të tyre. Sistemi i GDDS zëvendëson sistemin GDDS, i cili ishte*

*themeluar në vitin 1997. Vegëza në faqen NSDP të Kosovës do të jetë në dispozicion edhe në faqen Tabela e Buletinit të Standardeve të Shpërndarjes të FMN-së ( anglisht: Dissemination Standards Bulletin Board - DSBB) deri më 11 maj 2017. Qasja në faqen DSBB mund të bëhet në vegëzën: <http://dsbb.imf.org>.*